VENDIM
Nr. 8, datë 13.1.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1087, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2021" [1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12, të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave dhe tarifën e integruar doganore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 1087, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, në pjesën e dytë, seksioni VI, "Produktet e industrisë kimike apo të industrive të lidhjeve", kapitulli 30, "Produktet farmaceutike", kodi tarifor "3002 20 00 - Vaksinat për ilaç njerëzor, pa taksë -", ndryshohet dhe zëvendësohet me kodet tarifore, si më poshtë vijon:

"★ 3002 20 10 - - Vaksinat kundër koronavirusit të lidhur me SARS-in (speciet SARS-CoV), pa taksë -

★ 3002 20 90 - - Të tjera, pa taksë -".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

[1] Përafruar pjesërisht me rregulloren zbatuese të komisionit (EU) 2020/2159, amendim i aneksit i, të rregullores së Këshillit Evropian (EEC) nr. 2658/87, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 431, datë 21.12.2020.